# A K T - T H E M E L I M I

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "A L B L I " SH P K

Une Haki Zeqaj i biri i Mehmetit,i dtl 28.2.1955,lindur ne Ballesh dhe banues ne qytetin e Patosit Lagja e re nr 37,ortak i vetem i mbeshtetur ne ligjin 7638 dt 19.11. 1992 konform kerkesave te tij dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "A L B L I " SH.P.K.

Neni 1

Shoqeria ka emertimin e saj "ALBLI"SH.P.K. . Ajo do te kete seline e saj ne qytetin e Patosit rrethi Fier ne Lagjen e Re nr 37.Shoqeria mund te hapi zyra,perfaqesi e filjale ne tere teritorin e Republikes se Shqiperise duke respektuar kerkesat e ligjit.

Neni 2

Kohzgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte percaktuar 11 vjet. Ortaku i vetem ka te drejten e zgjatjes tej ketij afati si dhe te shperberjes se saj para afatit te percaktuar perçfardolloj shkaku qe ai e gjykon t te arsyeshem .

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise "ALBLI"SHPK eshte:

- Punime dheu,murature,betoni,betonarmeje,te zakonshme,punime shembjesh.
- Ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore,etj dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.
- Punime restaurimi.
- Ndertime vepra arti rrugore e hekurudhore.
- Ujsjellsa ,kanalizime,impiante vaditse.
- Import eksport,tregeti me shumice dhe pakice si dhe prodhim te lendeve te para te ndertimit ,parafabrikate,druri,metalike makineri e paisje pune ,per nevoja te vete shoqerise dhe per shoqeri te tjera,si d e çdo gjeje te domosdoshme qe i sherben realizimit te objektit te shoqerise.

Trasport malli per realizimin e aktivitetit te shoqerise dhe pe per te tretet.

Punime meremetimi,sherbimi e bojatisje ne popull.

Neni 4

Kapitali themelor i shoqerise"ALBLI"SHPK eshte 100.000(njeqin mije )leke.Ai eshte marre persiper dhe nenshkruar teresisht nga ortaku i vetem themelues.

Neni 5

Drejtimi i shoqerise "ALBLI"SHPK do te behet nga z.Haki Zeqa i cili do te jete administrator i kesaj shoqerije.

Neni6

Veprimtaria ekonomike financiare e shoqerise mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti.Administratori nxjerr bilancin i cili pasqyron aktivitetin financiar vjetor te shoqerise dhe ortaku i vetem vendos pas shlyerjes se te gjith detyrimeve dhe krijimit te fondit rezerve te shoqerise,per fitimin e saj per menyren e administrimit te tij.

Neni 7

Shoqeria per nevojat e veprimta-rise se saj puneson puntore e specialiste duke respektuar te gjitha rregullat ne fuqi per punesimin ne Republiken e shqiperise dhe per sigurimet shoqerore.

Keto rregullohen nepermjet kontrates se punes .Per çeshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacio nit per mardhenjet e punes.

Neni 8

Shperberja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe perçfardo lloj shkaku,si humbje te kapitalit te shoqerise,pamundesi veprimi ose me vendim te ortakut te vetem.Ne kete rast ortaku i vetem vendos mbi menyrat e likujdimit duke caktuar nje ose me shume likujdatore duke ju percaktuar atyre fuqite qe kane.

Ortaku i vetem i shoqerise perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themelor te shoqerise.

Neni 9

Rregullat e hollesishme per funksionimin e shoqerise jane percaktuar ne statutin e saj bashkangjitur ketij akti themelimi.

Tirane,me 12. 12.1994

ORTAKU I VETEM THEMELUES
HAKI ZEQAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
NR 248 REP
NR 102 KOL

V E R T E T I M

Sote me dt 12.12.1994 para meje noteres u paraqit personalisht Haki Zeqaj,madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar i panjohur me pare prej meje per identitetin ete cilit u sigurova nga leternjoftimi i tij personal, i cili me deklaroi se akti i themelimit i redaktuar dhe nenshkruar jasht kesaj zyre, shpreh vullnetin e lire dh te plote timin. Sa siper unee noterja e vertetoj dhe nenshkruaj.

N O T E R E

Irena Zaka

